

DHOMA E POSAÇME E  
GJYKATËS SUPREME TË  
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË  
LIDHEN ME AGJENCINË  
KOSOVARE TË  
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE  
SUPREME COURT OF KOSOVO  
ON KOSOVO TRUST AGENCY  
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA  
VRHOVNOG SUDA  
KOSOVA ZA PITANJA  
KOJA SE ODNOSE NA  
KOSOVSKU  
POVERENIČKU AGENCIJU

**ASC -09-0043**

Në padinë e

*Paditësja*

██████████ Person fizik  
Rruga Kaçaniku, Nr. 1, Prizren

kundër

*I Padituri/Ankuesi*

Përfaqësuar nga ██████████  
██████████

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtarë, në ankesën e të Paditurit kundër aktvendimit të Trupit Gjykues të DHPGJS-së të datës 8 korrik 2009, SCA-08-0074, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 11 tetor 2010, jep këtë

## **AKTVENDIM**

- 1. Ankesa është e bazuar.**
- 2. Aktvendimi i Trupit Gjykues të DHPGJS-së i datës 8 korrik 2009 (SCA-08-0075) modifikohet si në vijim:**
  - 'I. Aktvendimet për Përmbarim të Gjykatës Komunale në Prizren, E.nr.571/06 të datës 24 korrik 2006 dhe të datës 01**

**mars 2007, si dhe E.nr. 2229/07 i datës 30 qershor 2008 shpallen të pavlefshme.**

**II. Kur flitet për Ankesën, aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren i datës 17 shkurt 2005 (C.nr.450/2004) dhe aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren i datës 08 maj 2007 (Ac.nr.281/2005) shpallen të pavlefshëm.**

**III. Lënda C.nr. 450/2004 (Gjykata Komunale në Prizren), Ac.nr.281/2005 (gjykata e Qarkut në Prizren) tërhiqet nga gjykatat e rregullta dhe do të vendoset nga Trupi Gjykses i DHPGJS-së.'**

- 3. I Padituri obligohet paraprakisht që të paguaj në DHPGJS taksat gjyqësore në shumë prej 90 Euro për procedurën e ankesave**

Rrethanat procedurale dhe faktike:

Më 28 qershor 2004 Paditësja [REDAKTUAR] ushtroi padi kundër të Paditurit [REDAKTUAR] pranë Gjykatës Komunale në Prizren. Paditësja kërkoi nga gjykata që të aprovojë se ajo ka qenë dhe ende është në marrëdhënie pune me të Paditurin në vazhdimësi pas datës 27 dhjetor 1993 dhe se i Padituri i detyrohet asaj me rrogat për një periudhë të caktuar kohore. Padia ishte e regjistruar me numrin C.nr.450/2004. Më 17 shkurt 2005, Gjykata Komunale në Prizren për këtë lëndë lëshoi një aktgjykim në favor të Paditëses dhe këshilloi të Paditurin se brenda 15 ditëve pasi që është lëshuar aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa për Gjykatën e Qarkut në Prizren, përmes Gjykatës Komunale në Prizren.

Më 14 qershor 2005 (përmes postës së rregullt), i Padituri ushtroi ankesë kundër këtij aktvendimi në dy pjesë, datë 08 qershor 2005 dhe 14 qershor 2005, në bazë të shkeljeve themelore të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të të drejtës materiale. I Padituri kërkoi nga Gjykata e Qarkut në Prizren që të aprovojë ankesën, të

### III

anulojë aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Komunale në Prizren dhe që ta kthejë lëndën për rigjykim në Gjykatën Komunale në Prizren.

Gjykata e Qarkut në Prizren me aktvendimin e saj Ac.nr.281/2005 të datës 03 mars 2006 e hodhi poshtë ankesën e të Paditurit si të pasafatshme, pasi që aktgjykimi i Gjykatës Komunale i ishte dërguar të Paditurit më 24 maj 2005, ndërsa ankesa ishte paraqitur më 14 qershor 2005, prandaj nuk ka përmbushur afatin prej 15 ditësh të dhënë nga Gjykata Komunale në Prizren. Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut i është dërguar avokatit të Paditëses më 20 mars 2006 dhe përfaqësuesit të të Paditurit më 21 mars 2006.

Më 5 prill 2006, Paditësja dorëzoi në Gjykatën Komunale në Prizren një propozim për përmbarim (E.nr.571/06) të aktgjykimit C.nr.450/2004 duke kërkuar edhe pagesën për shpenzimet procedurale në shumë prej 160 Euro.

Me aktvendimin e saj E.nr.571/06 të datës 24 korrik 2006 Gjykata Komunale në Prizren vendosi për përmbarimin e aktgjykimit të Gjykatës Komunale Prizren kundër debitorit (të Paditurit), dhe këshilloi të Paditurin mbi mundësinë e ushtrimit të një ankese kundër këtij aktvendimi, brenda 8 ditëve pas dërgimit të tij, përmes Gjykatës Komunale në Prizren për Gjykatën e Qarkut në Prizren.

Dosja origjinale e Gjykatës Komunale në Prizren përmban një dokument të Gjykatës Komunale në Prizren (letër informuese), të datës 8 dhjetor 2006, e cila i adresohet Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (më tej AKM) në Prishtinë, me të cilën e informon AKM-në për procedurën përmbarimore të zhvilluar në atë kohë në Gjykatën Komunale në Prizren, sipas propozimit të [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] (Paditësja), kundër [REDAKTUAR] (i Padituri). Parashtresa mban vulën e Gjykatës Komunale në Prizren dhe është e nënshkruar nga Gjyqtari Qerim Fazlija, por nuk ka prova në dosje që dëshmojnë se ky dokument i është dërguar AKM-së.

Shkresa e lëndës përmban edhe një tjetër letër informuese, e datës 11 janar 2007, me të njëjtën përmbajtje si ajo e mëparshmeja, por, edhe pse mban nënshkrimin e të njëjtit gjyqtar, nuk mban vulën e gjykatës dhe sërish nuk ka ndonjë provë se i është dërguar AKM-së.

Dosja e Gjykatës Komunale nuk përmban njoftimin e qëllimit të Paditëses për të ushtruar padi të dorëzuar në AKM, siç kërkohet me nenin 29.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/18.

Pasi që i Padituri kundërshtoi, në bazë të nenit 48 të Ligjit mbi Procedurën e Përmbarimit (Gazeta Zyrtare e RSJ-së 20/1978, të ndryshuar), kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale të datës 24 korrik 2007 brenda afatit të paraparë me ligj, Gjykata Komunale mbajti seancë dëgjimore për të vendosur për atë kundërshtim. Pas atyre seancave dëgjimore në lëndën E.nr.571/06, Gjykata Komunale në Prizren, me aktvendimin e saj E.nr.571/06, të datës 1 mars 2007, u shpall jokompetente dhe e referoi lëndën e përmbarimit tek DHPGJS-ja.

Më 28 mars 2007, Paditësja ushtroi ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren të datës 1 mars 2007 në Gjykatën Komunale në Prizren për Gjykatën e Qarkut në Prizren.

Më 8 maj 2007 Gjykata e Qarkut në Prizren lëshoi një aktvendim përmes të cilit e aprovoi ankesën e kreditorit (Paditëses), e prishi aktvendimin e Gjykatës Komunale dhe e ktheu lëndën për rigjykim në Gjykatën Komunale.

Dosja e Gjykatës Komunale në Prizren lidhur me përmbarimin përmban një konfirmim të pranimit të datës 27 nëntor 2007 që dëshmon se Agjencia Kosovare e Privatizimit (më tej "AKP") ishte informuar dhe ftuar për seancën dëgjimore të caktuar për më 19 dhjetor 2007 në lëndën E.nr.2229/07, një numër i ri i lëndës i dhënë nga Gjykata Komunale në Prizren pasi që Paditësja aplikoi për plotësim të aktvendimit të përmbarimit. Sipas

procesverbalit të gjykatës të datës 19 dhjetor 2007 nuk ishte i pranishëm asnjë përfaqësues i të Paditurit apo AKP-ja, dhe gjykata megjithatë vendosi të mbajë seancën dëgjimore.

Më 30 qershor 2008 Gjykata Komunale në Prizren lëshoi aktvendimin plotësues të kërkuar në aktvendimin e datës 24 korrik 2006 (E.nr. 571/06) në numrin e lëndës E.nr.2229/07 dhe urdhëroi Bankën Ekonomike në Prizren që kreditorit (Paditëses) ti paguajë 17.243,10 Euro nga llogaria bankare e debitorit (të Paditurit), dhe këshilloi debitorin për mundësinë e ushtrimit të një ankese kundër këtij Aktvendimi brenda 8 ditëve nga dita e dërgimit të tij, përmes Gjykatës Komunale në Prizren për Gjykatën e Qarkut në Prizren. Aktvendimi iu dërgua kreditorit, debitorit dhe Bankës Ekonomike.

Më 17 korrik 2008 debitori (i Padituri) ushtroi ankesë kundër aktvendimit plotësues në Gjykatën Komunale në Prizren për DHPGJS-në. Ankesa u dorëzua në DHPGJS më 21 korrik 2008.

Më 08 korrik 2009, Trupi Gjykses i DHPGJS-së lëshoi një aktvendim (SCA-08-0074) dhe e refuzoi ankesën e të Paditurit si të papranueshme, duke deklaruar se DHPGJS-ja nuk ka juridiksion mbi ankesat kundër aktvendimit të përmbartimit.

Më 10 gusht 2009, AKP-ja, në bazë të nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, ushtroi ankesë kundër aktvendimit të Trupit Gjykses (SCA-08-0074) të datës 08 korrik 2009 në DHPGJS, duke kërkuar nga Kolegji i Ankesave që të rishikojë aktvendimin e Trupit Gjykses dhe të prishë aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.450/04 të datës 17 shkurt 2005 si dhe aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren E.nr.571/2006 të datës 01 mars 2007 pasi që këto janë marrë pa ndonjë bazë ligjore dhe ultra vires, sepse Gjykata Komunale dhe Gjykata e Qarkut nuk kishin juridiksion mbi lëndën.

**Arsyet ligjore:**

Ankesa është e pranueshme dhe e bazuar. Ajo shpie në modifikimin e aktvendimit të Trupit Gjykues, në shpalljen e aktvendimeve të Gjykatës Komunale dhe të Gjykatës së Qarkut në lëndën kryesore të pavlefshme dhe, kur flitet për ankesën, në shpalljen e aktvendimeve në fjalë të Gjykatës Komunale dhe të Gjykatës së Qarkut në lëndën e përmbartimit të pavlefshme.

Modifikimi i aktvendimit të Trupit Gjykues dhe shpallja e aktvendimeve të Gjykatës Komunale dhe të Gjykatës së Qarkut të pavlefshme është një rezultat i nevojshëm dhe logjik i arsytimit ligjor të dhënë më poshtë për shpalljen e aktvendimeve tjera të pavlefshme.

**Aktvendimet e Gjykatës Komunale dhe të Gjykatës së Qarkut në lëndën kryesore:****Juridiksioni:**

Gjykatat e rregullta nuk kanë dhe nuk kishin juridiksion lidhur me lëndën në fjalë. Sipas nenit 4.1 lit c të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 (që ka të njëjtin formulim sikurse dispozitat e tij të mëparshme, neni 4 lit c i Rregullores së UNMIK-ut 2002/12), DHPGJS-ja ka juridiksion parësor për paditë, duke përfshirë paditë e kreditorëve, të bëra kundër një ndërmarrjeje apo korporate, që aktualisht është ose ka qenë më parë nën autoritetin administrues të Agjencisë, kur këto padi kanë lindur gjatë, ose para se ndërmarrja apo korporata e tillë t'i jetë nënshtruar autoritetit administrativ të Agjencisë.

Padia e Paditëses natyrisht bie në juridiksionin parësor të përshkruar të DHPGJS-së, pasi që Paditësja kërkoi nga gjykata që ta shpallë atë se është në marrëdhënie të vazhdueshme pune me të Paditurin, një NSH që në bazë

të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 (të ndryshuar) është nën autoritetin administrues të Agjencisë. Padia lindi edhe gjatë një periudhe para kohës kur i Padituri erdhi nën autoritetin administrues të Agjencisë. Për atë që, pasi që paditësja kërkon të drejtën për pagesë të vazhdueshme të rrogave, padia ka lindur dhe rrjedh edhe gjatë kohës që i Padituri ishte/është nën autoritetin administrues të Agjencisë.

Tërheqja e padisë nga gjykatat e rregullta:

Sipas nenit 4.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 në lidhje me nenin 16.3 të UA UNMIK-ut 2008/6, nëse DHPGJS-ja konstaton se një gjykatë tjetër në Kosovë ka marrë në kompetencë rastin në të cilin DHPGJS-ja ka juridiksion parësor në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13 (respektivisht Rregulloren e UNMIK-ut 2008/4), DHPGJS-ja, pas marrjes së kërkesës nga pala për rastin në fjalë apo edhe pa marrë kërkesë, me iniciativë të vet dhe sipas zgjedhjes së vet do të dhe mund të iniciojë tërheqjen e lëndës nga gjykata, pavarësisht se në cilën fazë ndodhet procedura.

I Padituri, i përfaqësuar siç duhet nga AKP-ja (shih ASC-09-0108 et al.), argumenton në ankesën e tij se gjykatat e rregullta kanë ushtruar juridiksion në mënyrë të paligjshme. Ky argumentim mund të kuptohet si rezultat i tërheqjes së padisë sipas nenit 16.3 të UA UNMIK-ut 2008/6.

Neni 16.3 i UA UNMIK-ut 2008/6 thotë qartë se tërheqja mund të bëhet pavarësisht se në cilën fazë ndodhet procedura. Kolegji i Ankesave nuk ka nevojë të vendosë për lëndën në fjalë, nëse kjo do të përfshinte në përgjithësi autoritetin e DHPGJS-së për të ushtruar juridiksionin e saj edhe në këto lëndë, në të cilat gjykatat e rregullta ushtruan juridiksionin në mënyrë të paligjshme dhe në të cilat ato aktvendime të gjykatave të rregullta mund të jenë bërë të formës së prerë dhe ligjërisht detyruese për shkak të mosshfrytëzimit të mjetit juridik të njëjës prej palëve ose për shkak

vendosjes përfundimisht të mjetit juridik nga një shkallë tjetër e gjykatave të rregullta.

Lënda në fjalë ka disa aspekte specifike që, përveç mungesës së juridiksionit të gjykatave të rregullta, i bëjnë aktvendimet e tyre të pavlefshme. Një aktvendim i pavlefshëm nuk mund të bëhet i formës së prerë dhe ligjërisht detyrues:

Arsyet për pavlefshmërinë e aktvendimeve të gjykatave të rregullta lidhur me padinë kryesore:

Duke parë mungesën e juridiksionit të gjykatave të rregullta në lidhje me aspektet vijuese të këtyre aktvendimeve kjo shpie në përfundimin se aktgjykimet nuk i përmbushin kriteret për të qenë të vlefshme dhe detyruese:

Gjykatat e rregullta nuk kanë marrë në konsideratë se një padi kundër të Paditurit, si një NSH që është nën autoritetin administrues të Agjencisë, kërkon një procedurë specifike për të qenë e pranueshme. Në bazë të nenit 29.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/18, asnjë procedurë ligjore kundër një ndërmarrjeje nën autoritetin administrues të Agjencisë nuk do të mbahet në gjykatë nëse paditësi nuk siguron dëshmi se Agjencisë i është paraqitur njoftimi me shkrim lidhur me ngritjen e padisë në të cilën duhet të specifikohet emri i paditësit, emri i ndërmarrjes ose i korporatës dhe të dhënat e tjera identifikuese, baza e ankesës dhe ndihma e kërkuar. Qëllimi i njoftimit është që të informohet Agjencia për paditë (e mundshme), dhe t'ju japë atyre mundësinë që të trajtojnë lëndën në emër të NSH-së (ASC-10-0027 et al.), për të mbrojtur që Agjencia, si e tillë që është krijuar për të mbrojtur ndërmarrjet shoqërore dhe asetet e tyre në dobi të popullit, në çdo kohë mund të ushtrojë përgjegjësitë e saj dhe kështu, mes tjerash, të pengojë edhe veprimet e mundshme mashtruese para gjykatave të palëve të



cilët bëjnë marrëveshje të fshehta, një ratio legis që mund të shihet edhe në krijimin e DHPGJS-së si mbrojtës për ato procedura të tilla. Jo vetëm që gjykatat e rregullta nuk kanë kërkuar nga Paditësja që të ofrojë fakte lidhur me njoftimin të parapara me nenin 29.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/18, por gjykatat nuk kanë njoftuar as Agjencinë për padinë që pritej për tu zgjidhur para tyre. Njoftimi i parë – i vërtetuar – për Agjencinë u bë më 27 nëntor 2007, në procedurën lidhur me përmbarimin e deri atëherë tanimë – teorikisht – aktgjykimeve përfundimtare. Vetë aktvendimet, lidhur me padinë kryesore dhe procedurën përmbarimore, asnjëherë nuk janë dërguar formalisht tek Agjencia.

Gjithashtu, këshilla ligjore lidhur me mundësinë e ushtrimit të një ankese që është dhënë me aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren nuk ishte sipas ligjit. Gjykata Komunale dha këshillën që ankesa duhet të paraqitet në Gjykatën Komunale për Gjykatën e Qarkut brenda 15 ditëve nga dita e dërgimit të aktvendimit (siç duket sipas nenit 348 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore [LPK, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 4/77-1478, e nryshuar]), nuk ishte në pajtim me ligjin, pasi që në bazë të nenit 58.3 (ii) të UA UNMIK-ut 2008/6, ndaj një aktvendimi të një gjykate që ka vendosur për një padi për të cilën juridiksioni parësor i takon Dhomës së Posaçme, mund të bëhet ankesë në Dhomën e Posaçme kur ankesa është kundër aktvendimit të një gjykate në një lëndë për të cilën Dhoma e Posaçme ka juridiksion parësor. Në rastet e tilla, sipas nenit 59.1 të UA UNMIK-ut 2008/6, ankesa parashtrohet në Dhomën e Posaçme brenda dy muajve prej datës kur i dorëzohet Aktgjykimi palës që ankohet.

Kështu, Gjykata Komunale, duke dhënë këshillën e gabuar ligjore në mënyrën e ankesës, dhe Gjykata e Qarkut, duke e hedhur poshtë ankesën si të papranueshme edhe pse ishte brenda afatit për ankesë siç parashihet me nenin 59.1 të UA UNMIK-ut 2008/6, ia mohuan të paditurit të drejtën e tij për ndihmë juridike të paraparë me ligjin në fuqi.

Prandaj, për shkak të një numri të madh gabimesh në aktvendimet lidhur me padinë kryesore, dhe për shkak të shkeljeve të shumta të të drejtave të të Paditurit në lidhje me gjykimin e ligjshëm si dhe për shkak të të drejtës për ndihmë juridike të paraparë me ligj, duke marrë parasysh edhe mohimin e të drejtës së agjencisë për të ushtruar kompetencat themelore të saj që të bëj mbrojtjen e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore për hir të popullit, është e pashmangshme që aktvendimet në fjalë të shpallen të pavlefshme, të tërhiqet lënda nga gjykatat e rregullta dhe që të vendoset për të, si për padi të re, nga Trupi Gjykses.

Cetero censeo Kolegji i Ankesave konsideron të jetë e përshtatshme që të vihet në pah se sipas mendimit të tij ligjor një lëndë e cila është tërhequr nga gjykatat e rregullta pas një vendimi të gabuar që shkel juridiksionin e DHPGJS-së nuk mund të referohet (sipas nenit 4.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4) tek gjykatat e rregullta.

#### Pavlefshmëria e aktvendimeve të përmbarimit të gjykatave të rregullta:

Sipas arsytimit ligjor të dhënë më lartë, aktvendimet e Gjykatës Komonale dhe të Qarkut në Prizren nuk mund të konsiderohen të jenë të vlefshme, pasi që baza ligjore për ato, aktvendimet e Gjykatës Komonale dhe të Qarkut në Prizren në lëndën kryesore, janë të pavlefshme. Një vendim i përmbarimit nuk mund të qëndrojë kur baza e tij është e pavlefshme. Kur flitet për Ankesën, kjo duhej të theksohej që të shmangë ndonjë keqkuptim.

#### Modifikimi i aktvendimit të atakuar të Trupit Gjykses:

Siç pason nga arsytimi ligjor lidhur me aktvendimet e Gjykatës Komonale dhe të Qarkut në Prizren në padinë kryesore më lartë, aktvendimi i atakuar i Trupit Gjykses të DHPGJS-së i datës 8 korrik 2008, SCA-08-0074, që refuzon ankesën si të papranueshme duhej të modifikohet. Nuk ishte urdhëruar një

rigjykim, pasi që aktvendimi i Kolegjit të Ankesave konsiston në tërheqjen e lëndës nga gjykatat e rregullta. Lënda duhet të trajtohet si padi e re para Trupit Gjykses të DHPGJS-së.

Taksat gjyqësore:

Për procedurat e ankimeve (në Kolegjin e Ankesave) vlejné taksat gjyqësore në vijim (shih ASC-09-0072 et al):

Tarifat e taksave gjyqësore, neni 10.11 (ushtrimi i ankesës)	30 Euro
Tarifat e taksave gjyqësore, neni 10.15 lidhur me 10.22 (aktvendimet e gjykatës së shkallës së tretë)	60 Euro
Gjithsej	90 Euro

Këto taksa gjyqësore do të barten nga Ankuesi në bazë paraprake.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it

Torsten Frank Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar

Tobias Lapke, Regjistruer i EULEX-it